**LIGJ**
**Nr. 102/2017**

# PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 171/2014, "PËR PËRFUNDIMIN E PROCEDURAVE TË KALIMIT TË TOKËS BUJQËSORE TË ISH-NDËRMARRJEVE BUJQËSORE NË PRONËSI TË PËRFITUESVE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 171/2014, "Për përfundimin e procedurave të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve", të ndryshuar, bëhet ky ndryshim:

Neni 1

Në nenin 6, pika 1 ndryshohet si më poshtë:
"1. Afati për përfundimin e procedurave të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve mbyllet në datën 31 dhjetor 2018.".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 30.11.2017

**Shpallur me dekretin nr. 10683, datë 15.12.2017, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta**